

ORTAKËT THEMELUES

Z.Xhuljan DISHA
AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË "ENZO" SH.P.K.

Sot, më datë 16/08/2024

Z.Xhuljan Disha, shtetas Shqiptar, i biri i Defrim, lindur më 01/07/1996, në Tiranë /Shqipëri, banues në Tiranë/Shqipëri e mbajtës i ID me nr. J60701095G, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " ENZO " Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1 **EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "ENZO" Sh.p.k.

NENI 2 **SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Ullishtes", Hotel Olivar, Zona Kadastrale nr.3266, Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3 **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4 **OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Hoteleri, Bar-Kafe, Restorant, Shit-Blerje makinash, Makina me qera, Sherbime nderhyrese higjieno-shendetesore (Dezifektim, Dezinsektim, Deratizim). Vendi i kryerjes se veprimtarise do te zhvillohet ne te gjithë Republikën e Shqiperise. Sherbime lavaxerise per te trete

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe

të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z.Xhuljan Disha**, zoteron 1 kuotë, me 100 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributëve të reja inë para ose inë natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z.Xhuljan Disha**, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Z.Xhuljan Disha
